



## FJALORTHI

### SHPREHJE DHE PËRKUFIZIME KYÇE MBI “THIRRJE PËR PROJEKT IDE DHE BASHKËPUNËTORË” NË ZBATIM TË PROGRAMIT ACTIVATE PËR TIRANA KRYEQYTETI EVROPIAN I RINISË 2022

<b>Aplikuesi</b>	Çdo entitet, subjekt apo individ që ndjek, plotëson dhe dorëzon dokumentet e kërkuara në thirrjet e hapura (shihni më poshtë përkufizimet mbi termat organizatë e shoqërisë civile, grupe jo formale, partnerë)
<b>Autoriteti Kontraktues</b>	Subjekti me të cilin nënshkruhet kontrata e që ka tagrin për të lidhur një marrëveshje në kuadër të ‘Tirana European Youth Capital 2022’, në këtë rast Kongresi Rinor Kombëtar (KRK).
<b>Aplikimi</b>	Projekt ide e dorëzuar nga një entitet sipas kërkesave për të përmbushur kriteret e thirrjes, e cila përbëhet nga formularë specifikë që përshkruajnë projekt idenë në nivel narrativ, planifikues e financiarë, bashkëlidhur me disa dokumente standarde të përmendur qartësisht në thirrje.
<b>Aktivitet/e</b>	Pjesë përbërëse të një projekt ideje të cilat nënkuptojnë veprimet e ndërmarra dhe kryera që synojnë arritjen e një ose më shumë rezultateve të projektit. Për më tepër, janë pjesë përbërëse e pashmangshme për një planifikim të matshëm të një projekti dhe parashikohet të përshkruhen në detaje në formularin e aplikimit me përmbajtje titullin, llojin, kohëzgjatjen dhe specifika të tjera në varësi të llojit të tyre
<b>Buxheti</b>	Plani financiar për zbatimin e projektit dhe reflektimi i tij në trajta financiare të arsyetuara, duke plotësuar aneksin përkatës në paketën e aplikimit.
<b>Kohëzgjatja, Periudha e zbatimit</b>	Periudha që fillon nga data e nënshkrimit të marrëveshjes / kontratës së grantit deri në përfundimin e zbatimit dhe raportimit të projektit.
<b>Kostot</b>	Kostot totale, përfshirë gjithë ndarjen e kërkuar të kostove të ndryshme brenda implementimit të projektit.
<b>Marrëveshja e Grantit</b>	Instrument ligjor / Kontratë në lidhje me realizimin e projektit, i

	lidhur mes Autoritetit Kontraktues (KRK) dhe grant marrësit, i cili përcakton të gjitha modalitetet e zbatimit dhe raportimit të projektit.
<b>Periudha e Projektit</b>	Periudha e planifikuar dhe e akorduar nga palët në marrëveshjen e grantit gjatë së cilës fillon dhe mbaron zbatimi i projektit e për rrjedhojë edhe mbështetja e autoritetit kontraktues.
<b>Formulari i Aplikimit</b>	Një nga dokumentet bazë të detyrueshëm për tu plotësuar në kuadër të thirrjes për projekt ide apo thirrjes për bashkëpunëtorë. Ky dokument ndër të tjera kërkon zbërthimin në seksione të ndryshme të projekt idesë e ndër të tjera edhe objektivat, aktivitetet, rezultatet, partneritetin, etj. dhe jep informacion të detajuar për planin e punës dhe kërkesat financiare.
<b>Procedura e vlerësimit</b>	Është pjesë e procesit të përzgjedhjes së projektit. Është një procedurë e standardizuar dhe transparente që do të kryhet nga autoriteti kontraktues, në dy hapa: Hapi 1: Vlerësimi administrativ – gjatë kësaj faze do të kryhet kontrolli i dokumenteve të dorëzuara nga aplikuesi për të shqyrtuar nëse përmbushen kriteret sipas thirrjes. Hapi 2: Vlerësimi i projektit në aspekte përmbajtësore dhe operacionale – gjatë kësaj faze projektet e dorëzuara do shqyrtohen në aspekte të ndryshme duke u bazuar në elementët përmbajtësorë të kërkuar në formularin e aplikimit dhe aspekte të tjera operacionale si koherenca e projektit, efektiviteti, qëndrueshmëria, efektiviteti i kostove dhe kapacitetet financiare.
<b>Rezultati</b>	Rezultatet janë ndryshime të matshme që përfshijnë aftësitë ose aftësitë dhe kapacitetet e individëve ose organizatave dhe tregojnë ndryshimin që synon projekti.
<b>Vizibiliteti</b>	Vizibiliteti ka të bëjë me dukshmërinë dhe identitetin e një organizate, projekti ose nisme specifike dhe mund të krijohet duke përdorur logon dhe elementë të tjerë të komunikimit të organizatës apo nismës që mbështet projektin si dhe duke njohur dhe reklamuar kontributin e tyre në aktivitetet e ndryshme të komunikimit dhe projektit që organizohen.
<b>Target grup</b>	Kategori personash të cilët janë përfituesit e një projekt ideje. Grupi i synuar që është planifikuar e që merr benefitet në plan rezultatesh që lidhen me aktivitetet e projektit.
<b>Bashkëpunëtorë</b>	Në rastin e 'thirrje për projekt ide', me bashkëpunëtorë nënkuptohen institucionet që kanë lidhje me projektin dhe janë përfshirë në zbatimin e tij dhe që nuk përfitojnë në nivel financiar. Në rastin e 'thirrje për bashkëpunëtorë', me termin bashkëpunëtorë nënkuptohen entitetet aplikues që nuk kërkojnë mbështetje financiare, por që synojnë që aktivitetet e tyre ekzistuese t'ia atashojnë kalendarit të titullit Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022.
<b>Financuesi/donatori i projektit/iniciativës</b>	Entiteti që siguron mbështetje financiare dhe ndjek zbatimin e projektit.

<b>Grupe interesi</b>	Kategori të ndryshme të popullsisë që afektohen potencialisht apo konkretisht nga një projekt ide apo aktivitet i caktuar.
<b>Organizata të shoqërisë civile</b>	Duke iu referuar ligjit në fuqi, i referohemi entiteteve jo fitimprurëse, specifikuisht shoqatat, qendrat dhe fondacionet.
<b>Shpenzimet/Kostot Administrative</b>	Kostot që i referohen vendit/zyrës ku zhvillohet aktiviteti dhe ku vendoset stafi i projektit.
<b>Partnerët</b>	Me këtë term i referohemi entiteteve jo fitimprurëse dhe grupeve jo formale që kanë pranuar të zbatojnë një ose më shumë aktivitete të një projekt ideje së bashku me një tjetër entitet i cili njihet ndryshe si aplikues.